



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 102, Datë 27.05.2024

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË TARIFAVE TË ALPEX PËR TREGUN BRENDA SË
NJËJTËS DITË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3 pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; Kreu B.4 “Detyrimet e palëve”, gërma B.4.5.6. të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar; neneve 15 dhe 21 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.05.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 984/2 prot., datë 24.05.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX për tregun brenda së njëjtës ditë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me propozimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., mori vendimin nr. 287, datë 09.10.2023, mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.03.2024 si dhe ka filluar procedurën për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), mbështetur në konstatimet e këtij vendimi
- Bazuar në kërkesën e përcjellë nga shoqëria “ALPEX” sh.a. me shkresën nr. 53 prot, datë 31.01.2024, mbi zgjatjen e afatit të aplikimit të listës së tarifave të ALPEX, të miratuara me

vendimin e bordit të ERE nr. 287, datë 09.10.2023, ERE me vendimin e Bordit nr. 50, datë 02.04.2024 vendosi që Tarifat e ALPEX” do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.08.2024.

- Ndërsa me shkresën nr. 158 prot., datë 24.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 984 prot., datë 24.04.2024, “ALPEX” sh.a. ka paraqitur në ERE një kërkesë për miratimin e Listës së Tarifave në rolin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), në kuadër të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë.
- Duke qënë se shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a. është në proces Operacionalizimi të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë në Shqipëri dhe njëkohësisht Bashkimin e Tregjeve Shqipëri - Kosovë në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, kërkon miratimin e tarifave të propozuara lidhur me këtë aktivitet si më poshtë vijon:
 - Shtimin e Tarifës Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë;
 - Shtimin e Tarifës Variabël të Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë;
 - Shtimin e Tarifës Variabël të Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë.
- Gjithashtu nëpërmjet shkresës nr. 158 prot., datë 24.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 984 prot., datë 24.04.2024, shoqëria ka kërkuar dhe ndryshimin e emërimit dhe frekuencën e pagesës për dy prej tarifave aktuale si me poshtë:
 - Ndryshimin e emërimit të Tarifës vjetore të Trajnimit në Tarifa e Trajnimit si edhe ndryshimi i frekuencës së pagesës, nga pagesë vjetore të bëhet pagesë vetëm një herë;
 - Ndryshimin e frekuencës së pagesës së Tarifës së Provimit nga pagesë vjetore të bëhet pagesë vetëm një herë.
- Për sa i përket ndryshimeve të sipërcituara, ERE vlerësoi se ndryshimi i emërimit të Tarifës vjetore të Trajnimit dhe Tarifës vjetore të Provimit si dhe frekuencës së pagesës për dy prej tarifave aktuale të sipërcituara, do të jetë objekt rishikimi gjatë miratimit të “*Metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)*” bashkë me rishikimin e afateve të përcaktuara të tarifave të NEMO nga ALPEX, për të cilat afati i aplikimit të tyre është shtyrë së fundmi me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 50, datë 02.04.2024.
- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a. sqaron se për hartimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a. për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), janë marrë parasysht faktorët e më poshtëm:
 1. Tarifat e bursave të tjera të energjisë që tashmë operojnë siç janë Cropex, Ibex, Seepex, Opcom, MEMO.
 2. Tarifat që aplikon aktualisht ofruesi i shërbimit Henex dhe EnExclear,
 3. Mundësinë e mbulimit të shpenzimeve operative të ALPEX SHA si edhe kthimin e kapitalit brenda 7 (shtatë) deri në 10 (dhjetë) viteve nga fillimi i Operacionalizimit.

- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a. gjithashtu është shprehur se identifikimi i këtyre tarifave kundrejt tarifave të Tregut të Ditës në Avancë është i nevojshëm pasi Tregu Brenda së Njëjtës Ditë ka volume të vogla tregtimi ndërkohë që zhvillohet në tre ankande me orare të ndryshme dhe pas orarit zyrtar të punës duke kërkuar kështu domosdoshmërinë që të punohet me orare shtesë. ALPEX nuk ka akoma indikatorë për volume që do të tregtohen në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë dhe në pritje të miratimit të metodologjisë të llogaritjes së tarifave për NEMO, këto tarifa të propozuara do të jenë të përkohshme dhe do të ndihmojnë mbulimin e mëtejshëm të kostove operacionale. Gjithashtu nga eksperiencia e marrë nga Bursat e tjera Tarifat për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë janë thujse dy fish më të larta se Tarifat për Tregun e Ditës në Avancë.
- Lidhur me tarifën e propozuara nga ALPEX sh.a. bazuar në benchmark-et me vendet e rajonit, si CROPEX, IBEX, SEEPEX edhe EnExGROUP, konstatohet se këto janë të përafërta me ato të aplikuara dhe nga vendet e rajonit. Në mungesë të historikut për operimin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë, benchmark-u është konsideruar si metoda më e përshtatshme për të na sjellë sa më afër kostove reale deri në momentin e miratimit të tarifave mbështetur në *Metodologjinë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)*.
- Kërkesa e shoqërisë ALPEX sh.a. vjen në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra në cilësinë e të licencuarit “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, si dhe përgjegjësi të ndërmarra në zbatim të Rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregutit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar si dhe *Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 06.03.2020.
- Duke marrë në konsideratë faktin që metodologjia e përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është ende në proces miratimi, ku në zbatim të nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të datës 21 tetor 2021, ERE duhet të bashkëpunojë me ZRRE për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe Bashkimin e Tregjeve Shqipëri - Kosovë në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, në këto kushte, bazuar në kërkesën e paraqitur nga shoqëria ALPEX sh.a., vlerësojmë miratimin e pjesëshëm të kërkesës së paraqitur nga shoqëria ALPEX sh.a. për sa i përket “Listës së Tarifave të ALPEX” për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, të cilat do jenë të aplikueshme deri më 31.08.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Për sa i përket ndryshimeve të kërkuara në emërtimin e Tarifës vjetore të Trajnimit dhe Tarifës vjetore të Provimit si dhe frekuencën e tarifave të trajnimit dhe provimit, gjykojmë që këto

ndryshime të jenë pjesë e tarifave të miratuara pas miratimit të metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së ALPEX sh.a për miratimin e “Listës së Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”, të cilat do jenë të aplikueshme deri me 31.08.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). (Lista bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë shoqërinë AlpeX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.140 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.040 €	Anëtari i Bursës

- (a) Për tregun e Shqipërisë Tarifat Fikse do të shlyhen në monedhën Euro për jo-rezidentët
(b) Për tregun e Shqipërisë Tarifat Fikse do të shlyhen në monedhën Lekë.
(c) Mbi çdo tarifë do të aplikohet TVSH-ja.